

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE TREGTARE "TROIKAL SM & FT" sh.p.k.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket:

1- Shoqeria "FT MANAGEMENT & EVENTS " shpk me NIPT L72310504F, me seli ne adresën Lagja 13, Shkozë, Durrës, e përfaqësuar nga administratori i shoqerise znj Fatmira Takaj, lindur në Tiranë, dhe banues në adresën Tiranë, i identifikuar me ID, nr.karte identiteti G95120148T.

2- Sindikata e Pavarur e Minatoreve te Shqiperise , perfaqesuar nga Presidenti z.Gezim Kalaja, me seli në Tiranë, 21 Dhjetori , ish Ndermarria Gjeologjike , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin/pasaportën me nr. 036937572 dhe me nr. personal E70110222O

Krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Tropikal SM & FT " sh.p.k me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur **"TROIKAL SM & FT" shpk**. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private **"TROIKAL SM & FT" sh.p.k.** do te kete seline : "DURRES Lagja Nr. 13, Plepa",

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se ortakeve.



Objektivi i Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:

1) Hoteleri , Investime, pjesmarrje në fushën e ndertimit duke përfshirë të gjitha operacionet komerciale, turizmi , ndërtimore, industriale së bashku me shërbimet përkatëse që konsistojne në investimin, sipërmarrjen, realizimin, blerjen, shëndërrimin, kompesimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndërtimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, shërbimeve përkatëse specifike në konceptimin, krijimin, realizimin, tregtimin e mallrave të ndryshme me shumicë dhe pakicë, veprimtari në fushën e shit-blejes si dhe të gjithë formave të qirasë apo shfrytëzimit të pasurive të paluajtshme. Realizimin e kontratave marrëveshjeve, ortakërive dhe shoqërive të përbashkët. Shoqeria do te kryejë cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per te favorizuar ate. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes.

Neni 4

Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise do te jete paafat. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private "Tropikal SM & FT" sh.p.k do te jene pasurite : 1. **Pasuria "Njesi" me Nr.55/66/ND vol 16 Fq 203 ZK 8518 , Durres**

2. **Pasuria "Njesi " me Nr.55/67/ND Vol 16 Fq 204 ZK 8518 , Durres**

Pronesi e cila rezulton nga Certifikata për Vërtetim pronësie lëshuar nga ASHK më me nr. serial

1.1 Sipas dokumentacionit te paraqitur dhe shenimit te bere ne kartelen e pasurise rezulton se keto prona jane me pronare te vetem **ne masen 100 % Sindikata e Pavarur e Minatoreve te Shqiperise , 10/10 pjese takuese.**

Kapitali eshte i ndare ne **2 (dy)** kuota Vlera e kapitalit eshte ne baze te Raport Vleresimit Shoqerues.

Kapitali perbehet 100% nga kuotat e ortakeve. Ortaket e shoqerise **"TROIKAL SM & FT" SH.P.K.**, do te kene pjesmarrje ne kete forme :

1-Sindikata e Pavarur e Minatoreve te Shqiperise, (20 % nga kuotat e ortakeve) duke mbajtur 2/10 e pasurise me Nr.55/66/ND vol 16 Fq 203 ZK 8518 , Durres dhe 2/10 pjese takuese te pasurise me Nr.55/67/ND Vol 16 Fq 204 ZK 8518 , Durres (20 % nga kuotat e ortakeve)

2- Shoqëria tregtare " Ft Management & Events " Sh.p.k 80% nga kuotat e ortakeve) duke i kaluar 8/10 pjese takuese te pasurise me Nr.55/66/ND vol 16 Fq 203 ZK 8518 , Durres dhe 8/10 pjese takuese te pasurise me Nr.55/67/ND Vol 16 Fq 204 ZK 8518 , Durres

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj.

Administratori shoqerise do të jetë Z.Gerhard Takaj me ID . Ai është përfaqësuesi ligjor i Shoqerise në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve ne proporcion me kuotat.

Neni 8

Ortakët themelues kanë të drejtë të emerojnë dhe administrojnë të tjerë të vlerave materiale. Ka të drejtë të caktojë financiare, likuidator për problemet e shoqerise si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Neni 10

Shoqeria ka vullnet të saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në 3 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqerise "TROPICAL SM & FT" sh.p.k .

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët. Ortaku themelues i shoqerive

Sot me datë 11/12/2024, në Durrës, u hartua dhe u nënshkrua me vullnetin e plotë dhe të lirë të Ortakut, Akti Themelimit të "TROPICAL SM & FT" sh.p.k" sh.p.k., në 3 kopje, në gjuhën Shqipe, dhe me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKET THEMELUES

Shoqëria

"FT Management & Events" Sh.P.K

Sindikata e Pavarur e Minatoreve të Shqipërisë

Gerhard Takaj

Gezim Kolaço

